

## Sistemi i mbajtjes se dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve

1.Lista e dokumentave që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe afatet e ruajtjes.

Dokumentat pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave administrohen bazuar në Ligjin “Për arkivat” Nr.9154 datë 06.11.2003 “Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Rregulloren e Brendshme të DPD-së miratuar me Urdhërin Nr.146 datë 07.05.2018 të Ministrit të Financave “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”

Në mbështetje të sa më sipër, zyra e Sekretari/Protokollit harton pasqyrat emërtuese të çeljes së dosjeve në bazë të kritereve arkivorë, si: të objektit, të autorit, të korrespondentit, të ndarjes territorial-administrative, të llojit të dokumentit, të kohës dhe afatit të ruajtjes me RHK dhe të përkohshme.

2.Formën e dokumentave.

Format e dokumentave që ruhen dhe administrohen nga DPD janë:

- Kopje fizike
- Kopje fizike që kane bashkëlidhur, foto ose cd.